

<b>Emri i projektit:</b>	Ofrimi i shërbimeve me bazë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuar.
<b>Kohëzgjatja:</b>	01.07.2021 – 30.10.2022
<b>Shtrirja gjeografike:</b>	Ferizaj
<b>Buxheti total i grantit (EUR):</b>	59,990.00 EUR
<b>Objektivat:</b>	<p>Zgjerimi i ofrimit të shërbimeve sociale me cilësi të lartë për persona me aftësi të kufizuar për të përmirësuar mirëqenjen e tyre të përgjithshme.</p> <p>Fuqizimi i kapaciteteve të Qendrës me bazë në komunitet - Handikos Ferizaj në ofrimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuar</p>
<b>Grupet e synuara:</b>	Personat me aftësi të kufizuar, nga moshë +18, përfitues kanë qënë 40 përfitues direkt (persona me aftësi të kufizuar) dhe 80 familjar/kujdestarë.
<b>Përmbledhje e grantit:</b>	<p>Handikos Ferizaj përmes këtij projekti, synon të përmbush zbrastësitat në ofrimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuar (PAK) që jetojnë në komunën e Ferizaj, duke përmirësuar, mbuluar dhe siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet dhe duke iu pëgjigjur situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve me bazë në shtëpi që kanë për synim të përmirësojnë cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara duke ofruar shërbime bazë për lehtësimin e jetës tyre të përditshme dhe për përmirësimin e mirëqenies së tyre. Qëllimi i shërbimeve të ofruara në shtëpi është ofrimi i një game të shërbimeve multidimensionale, për të zhvilluar autonominë e individëve, duke eliminuar mundësinë e institucionalizimit dhe duke u ofruar përfituesve një mundësi për të fituar më shumë aftësi, autonomi dhe pjesëmarrje në jetën sociale dhe atë të komunitetit.</p>
<b>Donatori:</b>	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Handikos Ferizaj në partneritet me Save the Children.

